

KIS Interpretimi 7

Futja në Përdorim e Euros

Referencat

- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese*
- SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit* (rishikuar në 2003)
- SNK 27 *Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara* (rishikuar në 2008)

Çështja

- 1 Që prej 1 janar 1999, që është data e hyrjes në fuqi të Bashkimit Monetar dhe Ekonomik (BME), monedha euro bëhet monedha operuese me të drejta të plota dhe kurset e konvertimit të euro-s me monedhën lokale të vendeve pjesëmarrëse do të jenë pakthyeshmërisht fikse, d.m.th rreziku i diferencave që vijnë nga konvertimi me këto monedha eliminohen që nga kjo datë e në vazhdim.
- 2 Çështje mbetet zbatimi i SNK 21 në transformimin e monedhave lokale të Shteteve anëtarë të Bashkimit Evropian në euro ('transformimi').

Konsensus

- 3 Kërkesat e SNK 21 në lidhje me përkthimin e transaksioneve në monedhën e huaj dhe pasqyrave financiare të operacioneve në vende të huaja duhet të zbatohen saktësisht gjatë transformimit. E njëjta logjikë është e zbatueshme edhe në përcaktimin e kurseve të këmbimit për vendet që i bashkohen BME-së në periudha të mëvonshme.
- 4 Kjo nënkupton në veçanti që:
 - (a) aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj që vijnë si rezultat i transaksioneve do të vazhdojnë të përkthehen në monedhën funksionale me kursin e mbylljes. Çdo diferencë që rezulton nga konvertimi duhet menjëherë të njihet si e ardhur apo shpenzim, përveç rastit kur një njësi ekonomike do të vazhdojë të zbatojë politikën kontabël ekzistuese në lidhje me fitim/humbjet nga konvertimi të lidhura me mbrojtjet nga rreziku i valutës së një transaksioni të parashikuar;
 - (b) diferencat e konvertimit të akumuluar nga përkthimi i pasqyrave financiare të një operacioni të kryer jashtë vendit do të vazhdojnë të klasifikohen si kapital neto dhe të njihen si e ardhur apo shpenzim vetëm në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të vlerës neto të investimit në operacionin e kryer jashtë vendit; dhe
 - (c) diferencat e konvertimit që rezultojnë nga përkthimi i detyrimeve në monedhën e vendit pjesëmarrës nuk do të përfshihen në vlerën kontabël neto të aktiveve të lidhura.

Data e Konsensusit

Tetor 1997

Data e hyrjes në fuqi

Ky interpretim hyn në fuqi më 1 qershor 1998. Ndryshimet në politikën kontabël do të përfshihen në përputhje me kërkesat e SNK 8.

SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 4. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim.

Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.¹

SNK 27 (i ndryshuar në 2008) ka ndryshuar paragrafin 4(b). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2009. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (ndryshuar në 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.

¹ Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.